



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 2123, prot

Datë 02.07.2024

VENDIM

Nr. 23, datë 27/06/2024

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.12.2023 "PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024"

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni "18", neni "34", neni "40", neni "41", neni "54" germa "Dh", neni "55" pika 3, neni "64" germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017. "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni "4", neni "5" gjerat "a & ç", neni "6" germa "d", neni "7" pika "1", neni "21" pika "3", neni "23", neni "33", neni "39", neni "40", neni "41", Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit nr. 9, datë 20/03/2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, VKM nr. 306, datë 22.05.2024 si dhe shkresës nr. 1815/5, datë 27.03.2024 "Transferim fondi per shpenzime kapitale", pas diskutimit nga Këshilltarët:

VENDOSI:

1. Të bëjë shtesat dhe paksimet në programin buxhetorë sipas tabelës së mëposhtme;

000/lekë

Gr.	Tit.	Kap.	Viti	Artikull, nenartikull		Shuma
				Pakësim	Shtesë	
				602	231	
00	06260	01	2024	1653	1653	0
Totali				1653	1653	0

2. Kjo vlerë do të përdoret për supervizim dhe kolaudim per dy objekte të financuara gjate këtij viti nga buxheti i shtetit sipas emertimeve të mëposhtem,

- Supervizion për objektin “ Rikonstruktion i Kopështit të fëmijeve Fushë Arrëz” në vlerën 550 mijë kelë.
- Kolaudim për objektin “ Rikonstruktion i Kopështit të fëmijeve Fushë Arrëz” në vlerën 66 mijë kelë.
- Supervizion për objektin “ Rehabilitim i digës së rezervuarit Iballë” në vlerën 940 mijë kelë.
- Kolaudim për objektin “ Rehabilitim i digës së rezervuarit Iballë” në vlerën 97 mijë kelë.

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Seksioni i Financës, Inspektori për informimin publik në Bashkinë Fushë-Arrëz, si dhe Dega e Thesarit Pukë.

Ky vendim mori:

8 vota pro.

0 Vota kundër.

0 Vota abstenim.

Vendimi u zbardh me datë 02/07/2024.

SEKTRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

